

I nderuari ambasador shqiptar në Austri z. Roland Bimo

e nderuara kryesi,  
të dashur krijues, miq, udhëheqës shoqatash, aktivistë e njerëz të kulturës dhe artit,  
të nderuara zonja e zotërinj,

kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të kryesisë së Lidhjes t'ju dëshiroj mirëseardhje në këtë kuvend të parë të Lidhjes sonë dhe njëkohësisht t'ju falënderoj për ardhjen tuaj.

Nëntori si zakonisht na bën më shpesh bashkë, me larminë e aktiviteteve për nder të festave të shumta që përcolli e kaluara, ku u vendosën, të themi themelet e kombit tonë, kulturës, qëndrimit, traditës dhe gjuhës së bukur shqipe. Në këtë kontekst shfrytëzoj rastin t'jua uroj 22 nëntorin, ditën e alfabetit dhe 28 nëntorin, festën e flamurit dhe ditëlindjen e komandantit Adem Jashari.

Shoh ca reklama të ndryshme rrugëve të këtij qyteti dhe njërën do ta veçoja. Aty shkruan se kultura kushton, pra kërkon lekë, por pakultura, pra kultura e varfër shumë më shumë kushton. Pra, edhe ne jemi mbledhur sot që të shohim pak mbrapa, kah fillimi i misionit tonë, pastaj të diskutojmë për aktivitetet në përgatitje dhe të flasim për vizionin në të ardhmen. Për ne është shumë me rëndësi transparenca e punës tonë. Duke reflektuar kah ideja e reklamës më duhet të them që ne me shumë mund, sakrificë dhe shumë kohë dhuruar aktiviteteve të Lidhjes arritëm ta ngremë zërin e Lidhjes dhe të letrave shqipe që shkruhen në mërgatë në shumë qarqe të ndryshme si tek komuniteti ynë, ashtu edhe tek vendasit dhe të tjerët që jetojnë këtu në Austri.

Pikërisht para tri viteve poeti Anton Marku dha idenë që krahas shumë shoqatave të ndryshme shqiptare të krijohet një shoqatë e letrarëve shqiptarë në Austri. Kështu u krijua grupi inicues. Më 2 dhjetor 2014 bëhen plotë tri vite nga regjistrimi i Lidhjes pranë autoriteteve zyrtare. Përveç shumë botimeve individuale të autorëve tanë, ne mundemi të mburemi me dy antologjitë e parat të krijuesve shqiptarë në Austri, pra me Illyricumin në shqip dhe në gjermanisht. Kemi organizuar rreth 25 orë letrare, nga të cilat rreth 7 të fundit në dy gjuhë.

Përveç bashkëpunimit me gati të gjitha subjektet dhe asociacionet shqiptare në Austri e më gjërë, ne kemi nisur dhe thelluar bashkëpunimin me shumë shoqata, klube dhe subjekte vendase si LSH të Austrisë, PEN Klubin austriak, SHA për Letërsi, Shtëpinë e Letërsisë, pastaj me shkrimtarë e poetë të ndryshëm vendas dhe të huaj.

I falënderoj ata që na kanë përkrahur në rrugën tonë, si materialisht ashtu edhe moralisht dhe përkrahja e juaj është e mirëseardhur edhe në të ardhmen. Në veçanti falënderoj ambasadat shqiptare në Austri që na kanë përkrahur gjithmonë.

Uroj të kalojmë këndshëm në këtë kuvend dhe të arrijmë të ndahemi të kënaqur.  
Faleminderit.

Besim Xhelili, 30 nëntor 2014, Vjenë